



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 10

Prishtinë, më 20.12.2017, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Igor Simiq dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Albulena Haxhiu, Glauk Konjufca, Korab Sejdiu, Agim Aliu, dhe Shkumbin Demaliaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gramoz Paçarada, KDI; Shefki Kastrati, NDI dhe Pleurat Kurti, EUSR.

Mbledhjen e kryesoi, Hajdar Beqa, zëvendëskryetar i Komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës

Kryesuesi, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin për Buxhet të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Sami Kurteshi, paraqiti shqetësimin që nuk janë përkrahur amendamentet e Komisionit, duke pohuar se janë hedhur poshtë pa ndonjë arsytet të veçantë, dhe kërkoi që amendamentet e Komisionit të përkrahen në seancë plenare. Ndërsa, raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, tha se jam i pajtimit që të përkrahen.

Arben Gashi, tha se raporti me amendamente i Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës i plotëson kushtet formale-juridike dhe nuk ka vërejtje në aspektin procedural. Ndërsa sa i përket amendamenteve të dërguara në Komisionin për Buxhet nga Komisioni jonë është keq që nuk kanë kaluar, por mendoj se duhet t'i mbrojnë kryetarja e Komisionit ose dikush nga anëtarët dhe nëse është e nevojshme të flasim të gjithë anëtarët e komisionit, që ne i përkrahim amendamentet të cilat janë të arsyeshme.

Kryesuesi, tha se po biem dakord që ti përkrahim amendamentet e Komisionit tonë në seancë plenare edhe nëse grupet tona parlamentare mbajnë qëndrim ndryshe.

Pas diskutimeve, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018 dhe amendamentet e propozuara, janë pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim

3. Të ndryshme

Kryesuesi, bëri të ditur se Komisioni ka vendosur që punëtorinë për Rregulloren e Kuvendit ta mbajë më 26-28 dhjetor 2017 dhe kërkoi konfirmimin e pjesëmarrësve.

A. Shqyrtimi i shkresës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut

Po ashtu, Komisioni diskutoi për shkresën e dërguar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për persona të pagjetur dhe Peticione, në lidhje me përfshirjen e deputetes Mexhide Mjaku-Topalli në Grupin Punues për Rregulloren e Kuvendit.

Ndërkaq u tha se në shkresë nuk është sqaruar se për cilat pjesë mund të ftohet deputetja në fjalë, pasi që mandatin e kaluar e njëjta ka qenë përfaqësuesevetëmpërpjesën e Rregulloreskuflitetpërpeticionet.

Komisioni pas diskutimeve, njëzërivendosiqëpërbërja e GrupitPunuestëmbetet e njëjtë. Nësedeputetëkanëkomente, sugjerime apo vërejtje në lidhje me rastin e hartimit të Rregullores së punës së Kuvendit, atto mund ti dërgojnë në komision, por jo që të jenë pjesë e grupit punues sepse të gjitha grupet parlamentare janë të përfaqësuar në këtë grup punues.

Mbledhja përfundoi në orën 9:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryesuesi i komisionit,

Hajdar Beqa